

Qasja Juridike e Korrupsionit në Sektorin e Arsimit të Lartë dhe Mekanizmat Mbrojtës të Studentëve në Parandalimin e tij.

Jon Kola

Student, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës

Tetor 2025

Ky artikull u realizua në kuadër të projektit "Fuqizimi i Studentëve për Integritet: Lufta kundër Korrupsionit në Arsimin e Lartë", i cili zbatohet nga Qendra ALTRI. Projekti është pjesë e Programit të Granteve të Vogla SELDI, në kuadër të projektit "Shoqëria Civile për Qeverisje të Mirë dhe Kundër Korrupsionit në Evropën Juglindore: Ndërtimi i Kapaciteteve për Avokim të Bazuar në Evidencë, Ndikim në Politika dhe Angazhim të Qytetarëve (SELDI.net)", i financuar nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e këtij materiali është përgjegjësi e vetme e Qendrës ALTRI dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimet e Bashkimit Evropian apo të SELDI.net.

I. Hyrje

Korrupsioni përbën një nga elementët më sfidues të funksionimit të drejtë, transparent dhe me integritet të institucioneve publike. Ai është një plagë e fshehtë që ka një gamë të gjerë efektesh gjeryese në shoqëri. Ai minon demokracinë dhe sundimin e ligjit, çon në shkelje të të drejtave të njeriut, shtrembëron tregjet, gjerryen cilësinë e jetës dhe lejon që krimi i organizuar, terrorizmi dhe kërcënime të tjera ndaj sigurisë njerëzore të lulëzojnë.¹

Prandaj, adresimi i korrupsionit në arsimin e lartë kërkon një qasje të integruar ku përfshihet ajo juridike, institucionale dhe shoqërore. Në këtë kuadër, studentët nuk duhet të jenë vetëm përfitues pasivë të sistemit, por aktorë aktivë që luajnë rolin e tyre në forcimin dhe ruajtjen e integritetit akademik. Ky policy paper synon të analizojë kornizën ligjore që rregullon luftën kundër korrupsionit në arsimin e lartë në Shqipëri, si dhe të propozojë mekanizma të qartë për forcimin e rolit dhe mbrojtjen e studentëve në parandalimin e tij.

II. Korniza Ligjore dhe Institucionale

Duke patur parasysh efektet gjithëpërfshirëse të fenomenit korruptiv, patjetër që është e pashmangshme që ndikimi i tij të jetë prezent dhe në sektorin e arsimit të lartë. Në këtë sektor, korrupsioni mund të marrë forma të ndryshme, prej pagesave të paligjshme në formën e rryshfetit e deri te nepotizmi apo keqpërdorimi i fondeve të dedikuara ndaj institucionit akademik. Në fakt, kur analizojmë korrupsionin në arsimin e lartë, është e nevojshme që ky fenomen të shihet nga ana shoqërore po aq sa dhe nga ana juridike. Prandaj, mënyrat se si paligjshmëria e një veprimi mund të hyrë në spektrin e mënyrës së konsumimit të veprës penale të korrupsionit nuk futet, detyrimisht, në parashikimet ligjore të legjislacionit shqiptar për veprën penale të korrupsionit në mënyrë specifike, por më së shumti në ato vepra çka kategorizohen në grupin e atyre veprave kundër autoritetit të shtetit. Sipas Transparency International, korrupsioni përkufizohet si *abuzim të pushtetit të besuar për përfitime private*.² Në këtë kuadër, vishet dhe forma ligjore e veprave penale me natyrë korruptive sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.³

¹ (United Nations, 2004, p. iii)

² Transparency International. (n.d.). What is corruption? <https://www.transparency.org/en/what-is-corruption#define>
(Accessed November 2, 2025)

³ Ligji Nr. 7895, datë 27.1.1995, i ndryshuar, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”

Sipas Kodit Penal, korrupsioni, në formën aktive të tij, parashikohet si ***premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt deri në vlerën 50.000 lekë ose ekuivalencën në monedhë të huaj personit që ushtron funksionin publik, për vete ose për persona të tjerë për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën ose funksionin e tij, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në një vit.***⁴ Nga ana tjetër, po ky parashikim përmban një rrethanë cilësuese në paragrafin e dytë të tij ku në rast se ***përfitimi i parregullt i personit që ushtron funksionin publik, për vete ose për persona të tjerë, është mbi vlerën 50.000 lekë, ose ekuivalencën në monedhë të huaj, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.***⁵ Pra, rrezikshmëria e kësaj vepre penale vlerësohet në përputhje me masën e përfitimit personal që i drejtohet personit që ushtron funksionin publik. Në të njëjtën kohë, parashikim të ngjashëm ka edhe korrupsioni në formën pasive të tij⁶, duke patur parasysh vetëm ndryshimin në subjektin e figurës së veprës penale të tij.

Në të njëjtën kohë, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, përtej korrupsionit në formën e ngushtë të tij, parashikon dhe vepra penale të tjera me natyrë korruptive ku vlen të përmenden:

- Shpërdorimi i detyrës
- Shkelja e barazisë së shtetasve
- Përfitimi i paligjshëm i interesave
- Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike

Gjithashtu, përveç Kodit Penal që ka për qëllim kriminalizimin e veprimeve të paligjshme të subjekteve që kryejnë këto veprimtari, legjislacioni shqiptar parashikon rregullime të ndryshme me natyrë specifike që kanë për objekt mbrojtjen e personave që denoncojnë këto veprimtari apo parandalimin e këtyre veprimtarive. Një prej tyre është Ligji Nr. 9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”. Ky ligj garanton një vendimmarrjeje të paanshme, transparente, në interesin më të mirë të mundshëm të

⁴ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Neni 224 - Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike.

⁵ Po aty.

⁶ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Neni 259 - Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike. Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt ose i një premtimi të tillë deri në vlerën 50.000 lekë ose ekuivalencën në monedhë të huaj, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga personi që ushtron funksione publike, për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga dy deri në tre vjet. Po kjo vepër, kur përfitimi i parregullt ose premtimi i një përfitimi të tillë është mbi vlerën 50.000 lekë ose ekuivalencën në monedhë të huaj, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet.

publikut e të besimit të tij ndaj institucioneve publike, nëpërmjet parandalimit të konfliktit ndërmjet interesave publikë dhe atyre privatë të një zyrtari në ushtrimin e funksioneve të veta. Sipas këtij ligji, konflikti i interesit është ***gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisë të tij publike.***⁷ Një tjetër ligj që mund të mbrojë në mënyrë të drejtpërdrejtë interesat e studentëve në përditshmërinë e tyre është Ligji Nr. 60/2016, i ndryshuar “Për Sinjalizuesit dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve”. Sipas këtij ligji, në rastin e një sinjalizimi nga ana e studentit, kur vetë studenti është vënë në dijeni të një praktike korruptive, mund ta denoncojë atë dhe të mbrohet sipas dispozitave të ligjit ku parashikohet se ai gëzon konfidencialitet dhe mbrojtje ndaj hakmarrjes.

Përsa i përket Universitetit të Tiranës, në kuadrin institucional të tij, studenti mund të veprojë nëpërmjet përfaqësuesve të studentëve në Senatin Akademik, Këshillin e Etikës, Komisionet e Përherëshme të lejuara me statut dhe Këshillat Studentorë.⁸ Keta të fundit janë organizime të pavarura të studentëve të UT-së, të cilët përfaqësojnë dhe mbrojnë interesat e studentëve të UT-së në të gjitha programet e studimit.⁹

III. Gjendja aktuale e Korrupsionit në Arsimin e Lartë

Përgjatë viteve janë publikuar një sërë raportesh të organizatave ndërkombetare apo të organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri që flasin dhe përshkruajnë perceptimin e studentëve mbi cilësinë e arsimit të lartë në Shqipëri apo korrupsionin në këtë sektor. Një raport i Qëndresa Qytetare¹⁰ për vitin akademik 2018-2019¹¹, ka gjetur se 73% e kampionit të anketuar, thonë se korrupsioni ekziston në universitetet e tyre. Ndërkohë, një iniciativë e Friedrich Ebert Stiftung e quajtur Youth Study, ka nxjerrë se 68.1% e të anketuarve besojnë se janë të pranishme rastet kur notat dhe diplomat “blihen” në institucione/universitete në Shqipëri¹².

⁷ Ligji Nr. 9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike” – Neni 3, pika 1

⁸ Statuti i Universitetit të Tiranës, Neni 129 – Përfaqësuesit e Studentëve

⁹ Statuti i Universitetit të Tiranës, Neni 130, pika 1 – Këshillat e Studentëve

¹⁰ Qëndresa Qytetare. (2019). Korrupsioni në universitetet publike në Shqipëri.

¹² Friedrich-Ebert-Stiftung. (2024). Youth study Albania 2024

<https://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/21498-20241212.pdf>

Këto studime nënvizojnë faktin se studentët nuk e vlerësojnë korrupsionin si një fenomen të izoluar, por si një përvojë që integrohet me jetën e tyre në universitet, çka dhe nënvizon besimin e ulët që kanë të rinjtë për institucionet arsimore. Në këtë kuadër, normalizimi i këtyre sjelljeve, mund të sjellë pasoja afatgjatë për studentët, pasi hyrja në tregun e punës do të jetë më e vështirë me një perceptim të deformuar mbi etikën profesionale dhe ndershmërinë. Prandaj, përballja me këtë fenomen nuk është thjesht çështje juridike, por një domosdoshmëri për të rikthyer besimin e studentëve në vlerat e drejtësisë, meritës dhe transparencës.

IV. Konkluzione dhe Rekomandime

Analiza e korrupsionit në arsimin e lartë në Shqipëri tregon se ky fenomen mbetet nga sfidat më serioze për integritetin akademik dhe cilësinë e sistemit arsimor. Pavarësisht ekzistencës së një legjislacioni që ndalon korrupsionin dhe që promovon transparencën, zbatimi i saj në mënyrë institucionale rezulton shpesh i dobët dhe joefektiv. Kjo krijon një cikël të mbyllur ku shkeljet mbeten të pandëshkuara dhe korrupsioni vazhdon të perceptohet si pjesë e kulturës institucionale. Për rrjedhojë, përballja me korrupsionin në arsimin e lartë kërkon jo vetëm masa ligjore, por një ndryshim të thellë kulturor dhe institucional që nxit përgjegjshmëri, ndershmëri dhe pjesëmarrje aktive të studentëve.

Në këtë kuadër, është e nevojshme që institucionet e arsimit të lartë, të promovojnë dhe forcojnë zbatimin e dispozitave ligjore që parandalojnë korrupsionin dhe të krijojnë struktura të qarta për sigurimin e integritetit akademik. Një shembull i mirë, i cili në bindjen time, do të ishte efektiv dhe në Shqipëri, është ai i Universitetit të Bolonjës që ka krijuar Ombudsmanin e Studentëve. Ky organ ka për detyrë të marrë raporte mbi mosfunksionimet dhe kufizimet që ndikojnë në të drejtat e studentëve. Ky organ i pavarur nuk raporton në mënyrë hierarkike ose funksionale, në asnjë mënyrë, tek Organet e Universitetit dhe ekziston vetëm për të siguruar pajtueshmërinë me rregulloret aktuale.¹³

¹³ Statuti i Universitetit të Bolonjës, Neni 15

Bibliografia

- Friedrich-Ebert-Stiftung. (2024). Youth study Albania 2024
- Ligji Nr. 7895, datë 27.1.1995, i ndryshuar, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”
- Ligji Nr. 9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike
- Ligji Nr. 60/2016, i ndryshuar “Për Sinjalizuesit dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve”
- Statuti i Universitetit të Bolonjës
- Statuti i Universitetit të Tiranës
- Transparency International. “What is corruption?”
- Qëndresa Qytetare. (2019). Korrupsioni në universitetet publike në Shqipëri.
- United Nations Convention against Corruption